



## **Asociacioni i Universiteteve Evropiane**

### **UNIVERSITETI I MITROVICËS** **Raport nga vizita e AUE, 10 - 13 Dhjetor 2002**

#### **I Hyrje**

##### 1.1 Permbajtja

Vizita e AUE Universitetit te Mitrovices u organizua me kerkesen e Departamentit te Arsimit UNMIK parashtruar ne vjeshte 2002, u ndermorr ne kontekstin e aktiviteteve prioritare te AUE-se per Evropen juglindore dhe u financua nga programi i Bankes Boterore per perkrahjen e ringjalljes se Arsimit te Larte ne Kosove.

UNMIK ftoi AUE te ndermarre nje vizite te tille brenda kontekstit te perpjekjeve per reformimin e arsimit te larte ne Kosove. Arsimi i larte publik per nje kohe te gjate ka qene burim aktual dhe potencial i konfliktit ne Kosove, duke senzibilizuar ceshtjen e dispozitave institucionale. Sidoqofte garantimi qe te gjithe qytetaret e Kosoves te kene qasje ne arsimim te larte cilesore Evropiane eshte nje nga veprimet kyqe qe do te sjellin nje te ardhme pozitive per qytetaret ne regjion. Reforma e arsimit te larte, ne hap me trendet dhe zhvillimet evropiane, pra ka qene kryesore per misionin jo vetem te UNMIK-ut por edhe te organizatave te tjera te Komunitetit Nderkombetar.

Themelimi i Univerzitetit te Mitrovices eshte perkrahur nga UNMIK, dhe roli i UNMIK e veqanerisht kontributet personale te stafit te tij meritojne te pranohen qe nga fillimi. Profesor Michael Daxner, ish Administrator Nderkombetar pergjegjes per Arsimin e Larte dhe Bashkedrejtues i Departamentit te Arsimit punoi palodhshem dhe me nje diplomaci te jashtezakonshme prej 2000 – 2002 te krijojte Universitetin e Mitrovices si nje furnizues vital te arsimit te larte i cili nuk do te jete vend perqendrimi per ballafaqime politike. Pa perpjekjet e medha, per perkujdesje per angazhim nderkombetar dhe inkurajim per reforma evropiane, progresi, qe eshte bere ne sigurimin e te drejtes per arsimim per te gjithe qytetaret e Kosoves, nuk do te ishte i mundur. Ideja per perfshirjen e Asociacionit te Universiteteve Evropiane ne kete proces gjithashtu erdhi nga Profesor Daxner, prandaj nuk eshte e tepert te thuhet se pa te ky raport nuk do te ishte i mundur.

Projekti i tanishem i reformes vazhdon, plotesisht dhe me zotesi, te perkrahjet nga Dr Abdul Aziz Khan, pasuesi i Michael Daxner, si Drejtues i Arsimit UNMIK Ne nderkohe ne Mitrovices, eshte krijuar nje raport i afert dhe plot besim i punes, ne mes UNMIK dhe Universitetit te Mitrovices, duke iu falenderuar posaqerisht perpjekjeve te Zyrtarit Regjional te Arsimit te UNMIK-ut, Patrick Duong. Gjate dy viteve te kaluara, ndikimi i punes se Patrick Duong, ne nje mase te konsiderueshme, eshte perforcuar permes pjesemarrjes se ekspertit nderkombetar, Georg Woeber, i cili punon drejtpersedrejti me Universitetin e Mitrovices ne implementimin e reformave konkrete qe kane per qellim ta vene Universitetin ne hap me trendet Evropiane, zhvillimet dhe standardet. Derisa Georg Woeber i raporton drejtperdrejt Drejtuesit te Arsimit UNMIK, maredheniet e tij te aferta te punes me Patrick Duong, kane qene faktori vendimtar ne progresin e shkelqyer ne ristrukturimin dhe riorganizimin e universitetit. Pa kete kombinim te perkrahjes politike te UNMIK-ut, udheheqjes teknike te ofruar brenda projektit te reformes universitare, si dhe qendrimin pozitiv per bashkepunim te udheheqesise se universitetit, asnje nga keto te arriturat te deritanishme nuk do te ishin te mundura.

## 1.2 Qellimi i vizites

Qellimi i kesaj vizite paraprake ishte qe te dihet sa me shume qe eshte e mundur rreth kushteve nen te cilat Universiteti i Mitrovices funksionon, dhe te keshilloje rreth planeve per sigurimin e arsimit te larte te duhur kualitativ ne regjion.

Ekipi i AUE ishte i udhehequr nga Alojz Kralj, ish Rektor i Universitetit te Lubjanes dhe anetar i AUE programi per Rishqyrtim Institucional Komisioni Drejtues. Anetaret tjere te ekipit te AUE ishin Profesor Ivan Ostrovsky, Prorektori i Universitetit Comenius, Bratislave, Manja Klemencic, ish Sekretar i Pergjithshem i ESIB – sindikatave kombetare te studenteve ne Evrope – dhe David Crosier, AUE menaxher i programit i cili ishte ne cilesi te sekretarit te ekipit.

Edhe pse qellimi i misionit ishte veqanerisht i kufizuar rreth ceshtjeve te natyres teknike dhe akademike, atmosfera tejet e ndjeshme politike ishte e mirenjohur. Pikenisja per ekzaminimin e Universitetit te Mitrovices eshte qe te gjithe qytetaret qe shprehin deshire dhe potencial te perfitojne nga mesimet ne arsimin e larte, do te kene mundesi ta bejne kete. Pa arsim te larte kualitativ, dobite nga shkembimet per brenda komuniteteve nderkombetare akademike Evropiane, nuk do te kete ndryshime pozitive drejt nje shoqerie stabile, demokratike, tolerante te perforcuar me zhvillim ekonomik.

Momentalisht kushtet nuk ekzistojne per arsim te larte ne gjuhen serbe ne institucionet tjera te larta ne Kosove, keshtu qe Universiteti i Mitrovices ballafaqohet me nevoja te verteta shoqerore. Per me teper universiteti eshte themeluar dhe lejuar nen autoritetin e UNMIK-ut ne mungese te ligjit te duhur mbi arsimin e larte ne Kosove. Pasi Universiteti i Mitrovices eshte nje institucion ne Kosove, mbesim me shprese qe Universiteti i Mitrovices te inkorporohet per brenda kornizes ligjore Kosovare ne te ardhmen e afert.

Programi per kete vizite ishte posaqerisht mire i organizuar nga Sekretari i Pergjithshem Ranko Djokic ne bashkepunim me Patrick Duong dhe Georg Woeber, dhe per dy dite e gjysem ekipi pati mundesi te vizitoje te gjitha fakultetet ekzistuese, pati takime me

dekanet, profesoret, administratoret dhe studentet. Te gjithë bashkebiseduesit dukej te ishin te pregaditur mire per diskutim. Ekipi i AUE posaqerisht falenderon Rektorin Gojko Savic dhe Sekretarin e Pergjithshem Ranko Djokic per punen e tyre te palodhshme dhe fleksibile duke siguruar qe te plotesohen te gjitha nevojat e ekipit perkunder paralajmerimit te shkurter.

Edhe pse ekipi i AUE beri perpjekje te konsiderueshme te verifikoj informatat, dhe ne kete raport u orvat te konturoje pershtypjet me sa me teper objektivitete, nje numer kufizimesh duhet te tregohen qe nga fillimi:

Se pari, per shkak te kohes se shkurter te mundesuar per vizite, nuk ishte e mundur te gjurmohen me hollesisht ceshtjet e rendesishme.. Prandaj verejtjet ne kete raport nga disa ane mund te jene siperfaqesore e nga disa te tjera te gabuara.

Se dyti, shume pak informata te shkruara dhe te besueshme u mundesuan nga universiteti. Shumica e pyetjeve sa i perket mjeteve financiare dhe menaxhimit te informative hasen ne pergjigje me vleresime subjektive, por jo te mbeshtetura nga ndonje informate statistikore e besueshme. Kjo do te thote se eshte e pamundur per ekipin e AUE qe te jete i sigurte per natyren e vertete te veprimeve brenda universitetit. Per shembull, eshte veshtire te dihet se sa studente, personel akademik dhe jo akademik jane momentalisht duke punuar ne universitet, si dhe plotesisht te kuptohen kanalet e financimit.

Me aq kufizime, rishqyrtimi paraprak vetem mund te parashtroje pyetje, te ngre ceshtje dhe te sugjeroje opsione, derisa komentet e hollesishme rreth zgjedhjeve te posaqme te ndermarra duhet te jene rezultat i nje detyre me rrenjesore ne te ardhmen. Ambicia e ketij raporti prandaj eshte te parashtroje nje numer pyetjesh te cilat ne i konsiderojme te rendesishme per ti u drejtuar Universitetit, natyrisht jo te mundesoje ndonje zgjidhje te lehte.

## **II. Verejtjet Paraprake**

Ceshtja e pare te cilen ekipi i AUE do ta theksonte eshte se nevoja per arsim te larte kualitativ ne kete regjion eshte absolutisht vendimtare nese nje e ardhme si duhet parafytyrohet per qytetaret e Kosoves. Momentalisht, qyteti i Mitrovices dhe regjioni i Kosoves Veriore nuk jane duke vuajtur vetem si rezultat i katastrofes njerezore te shkaktuar nga politika etnikisht perqarese e te kaluares, por edhe nga depresioni i theksuar social dhe ekonomik. Kompleksi gjigant dhe ne mase te madhe i braktisur i minieres se Trepces ne Mitrovice mbizoteron pamjen si nje vizion i nje periudhe industriale tashme te kaluar, derisa asnje zhvillim i ri ekonomik nuk ka filluar.

Gjate vizites sone u be e qarte se Universiteti i Mitrovices eshte i vetmi institucion i rendesishem publik ne Kosoven veriore. Edhe pse asnje universitet nuk mund te marr si i vetem pergjegjesine per drejtimin e moszhvillimit politik, social dhe ekonomik, Universiteti i Mitrovices duhet te kete rolin kyq ne ringjalljen ekonomike, duke dhene shpresa per nje te ardhme me te mire.

Sidoqofte u pa qarte se ne kete periudhe shume te paqendrueshme dhe jostabile, Universiteti i Mitrovices, me nje histori komplekse dhe te trubullt prapa vehtes, duket qe momentalisht eshte ne kerkim te identitetit te tij. Derisa shume studente dhe profesore qe i takuam ishin te dhene pas vizionit nostalgjik te se kaluares, eshte e qarte qe, nga nje pikepamje e jashtme, Universiteti i Mitrovices duhet te shkoje drejt nje te ardhme tjeter. . Me mire do te ishte qe ne vend se te veproje si nje grup i kufizuar dhe i kthyer nga brenda i fakulteteve, me pak brengosje per boten e jashtme, te zhvilloje nga fillimi nje institucion nderkombetar te vertete Evropian. Te ekzistosh si nje institucion nderkombetar nenkupton inkorporimin e instrumenteve ne cdo nivel qe do te promovonte dhe mundesonte bashkepunim nderkombetar. Per shembull, mesimi i gjuheve te huaja, qasja ne internet, kerkimi i kontakteve te jashtme per zhvillim te projekteve, nxitja e ndryshueshmerive ne mesime dhe hulumtime te gjitha keto duhet te jene prioritete te qarta te universitetit (te diskutuara ne vijim te ketij raporti). Zhvillimi i bashkepunimit nderkombetar nuk duhet te kuptohet si nje rol shtese fakultativ i universitetit, por me teper si pjese e misionit te tij qendror qe do te inegrohet ne te gjitha aspektet e punes se universitetit. Kjo do te thote se ky eshte nje process afat gjate dhe kerkon pune intensive. Kjo duhet te mundesohet permes perpjekjeve te perbashketa te administratoreve, personelit dhe studenteve, te cilet me se pari kane nevojte per gjuhe te huaja dhe qasje ne internet qe te kerkojne mundesite per pjesemarrje ne ngjarjet dhe projektet arsimore, si dhe te shfrytezojne mundesite per financim.

Universiteti i Mitrovices duhet te demonstroje se mund te jete nje institucion gjithepershires, i hapur kah bota. Ne vend qe te koncentrohet ne rikrijimin e universitetit te kaluar nga i cili eshte zhvilluar, Universiteti i Mitrovices duhet ta shohe te ardhmen e tij ne region, ne Evrope, dhe me gjere ne bote.

Sidoqofte, nje numer i konsiderueshem i studenteve dhe profesoreve qe i takuam ende e konsiderojne universitetin si “universitet ne ekzil”, duke pritur rastin qe te kthehen ne lokalet e tyre origjinale. Ky vizion duket se inkurajohet nga mediat serbe dhe politikanet, dhe fuqia e tyre konceptuale nuk duhet te nencmohet. Sidoqofte, sipas nesh, ky eshte nje vizion i kote dhe joproduktiv politik i cili vetem se do te veshtiresoje, vonoje zhvillimet ne universitet.

Akteret tjere kyq ne universitet – perfshire ketu Rektorin, dekanet dhe Sekretarin e Pergjithshem – na dhane nje qendrim me real, duke pranuar se universiteti duhet te vendoset dhe zhvillohet ne Mitrovicen Veriore. Per keta pjesemarrjes kyq, eshte e qarte se arsimi i larte ne Mitrovice duhet te zhvillohet jo si nje zgjidhje e perkohshme e realitetit momental, por ne nje perspektive te transformimit te realitetit momental.

Perkunder dallimeve te rendesishme ne perceptimin e rolit te universitetit, gjithte personeli dhe studentet qe ne takuam ishin te pajtimit se e ardhmja e universitetit duhet ngushte te jete e lidhur me zhvillimet ne arsimin e larte ne pjesen tjeter te Serbise.

Ne disa raste ekipi i AUE kerkoi te dije nga akteret e ndryshem rreth asaj se cka presin ne te ardhmen rreth financimit te universitetit nga Ministria e Arsimit te Kosoves. Per shumicen derrmuese, pergjigjja ishte se nje scenario i tille nuk mund te mirret me mend edhe per nje kohe. Sidoqofte, udheheqesia e universitetit deklaroi se eshte e hapur te diskutoje rreth ketyre ceshtjeve financiare. Ne mbledhjen e rastit pas vizites se AUE,

Ministri Osmani gjithashtu shprehu gadishmerine e tij te takoje udheheqesine e Universitetit te Mitrovices per bisedime rreth kesaj ceshtje, dhe ekipi i AUE me siguri se do te inkurajoje nje dialog te tille.

### **III Informatat themelore rreth Universitetit te Mitrovices**

Pasi qe universiteti ka perjetuar ndryshime dramatike dhe levizje ne keto vitet e kaluara, eshte jashtezakonisht veshitare te krijohet nje “fotografi” stabile e situates se universitetit sot. Ne te vertete ekipi i AUE ishte i vetdijshem se shume pergjegjje ne pyetje u bene duke iu referuar praktikës se kaluar te universitetit. Madje edhe informatat e kufizuara statistikore qe na u ofruan dukej se i referoheshin situates ne te kaluaren më parë se realitetit momental. Per kete arsye, bile edhe informatat me themelore, si numri i personelit dhe studenteve, nuk mund te konsiderohen si te besueshme.

Ne numrin e shpallur te studenteve 11,450 duket qe studentet aktiv, studentet e regjistruar se fundi por si “joaktiv”, si dhe studentet e regjistruar me heret ne universitet, jane te perfshire te gjithë. Me nje amalgamë te tille te informatave, eshte e pamundur te konstatohet ne asnje shkalle te sigurise se sa eshte numri i studenteve qe aktualisht studiojne ne universitet. Prandaj kerkohen mjetet normale te menaxhmentit institucional per te konstatuar informatat korrekte, dhe si te tilla duhet te paraqiten pra pa ekzagjerime.

Sa i perket shpartallimit gjeografik te numrit te studenteve, nga nje lloj vleresimi qe e beme me studentet qe i takuam neper klasa ne universitet, nje vleresim i perafert eshte se rreth 60% e studenteve jane nga Kosova, me rreth nje te terten e tyre nga Mitrovica. Studentet tjere vijne nga ane te ndryshme te Serbise dhe Malit te Zi, dhe nje numer i vogel nga Bosnja dhe Hercegovina.

Informata e sakte, rreth regjistrimit dhe perqindjes se atyre qe perfunduan, ishte e pamundur te sigurohej. Sidoqofte, nga raportet gojore, duket qe shume – deri ne 90% - te diplomuar nga shkolla e mesme regjistrohen ne universitet. Sidoqofte sa – dhe sa prej tyre, eshte e paqarte – e braktisin pas vitit te pare. Universiteti duhet ta kuptoje sistemin e regjistrimit dhe braktisjes, dhe te marre pergjegjesi per studentet e vet.

Gjithashtu eshte e paqarte se sa studente jane te regjistruar nen buxhetin e shtetit Serb, dhe sa prej tyre jane qe “vet-financohen”. Prej evidences anekdotike, duket se rreth gjysma e studenteve aktiv ne mesime jane te financuar nga shteti, deri sa studentet qe “vet-financohen” nga Kosova jane momentalisht te shkarkuar nga pagesa per shkollim. Ne nuk kemi nje menyre me te sigurte per te vleresuar numrin e studenteve qe e bejne pagesen per shkollim, dhe shuma e pageses duket se ndryshon shume sipas fakulteteve.

Problemi i ngjajshem i besueshmerise se informatave ka te beje edhe me numrin e personelit te universitetit. Numri i personelit akademik i prezantuar ne leter kap numrin prej 728. Sidoqofte, prej tyre, eshte e paqarte se sa jane punetore te universitetit, dhe sa prej tyre jane lektore te jashtem te punesuar fillimisht nga nje institucion tjetër.

Kjo informate eshte themelore per vleresimin e kapacitetit institucional, por nuk eshte qarte e prezantuar ne dokumentet zyrtare univerzitare. Ne mesuam, per shembull, gjate vizites qe i beme fakultetit ekonomik ne Zubin Potok, se **asnje** mesimdhenes nuk banon ne qytet. Kjo mund te jete vecanti e ketij fakulteti, pasi qe arsyet e njemendeta, per vendosjen e fakultetit ekonomik ne nje qytet qe eshte i shkeputur prej pjeses tjetere te universitetit, duket qe jane te pakapshme si per profesoret ashtu edhe per studentet, dhe me te vertete ne nuk mundem te mesojme se si dhe prej kujt eshte marre nje vendim i tille. Sidoqofte, nuk eshte e pershtatshme qe nje fakultet te kete te gjithe personelin akademik te jashtem, dhe nje sistem i tille do te kete ndikim serioz negativ ne kualitetin e mesimdhenies ne institucion.

Shkurt, eshte me rendesi qe nese universiteti do te mund te reformohet dhe te zhvillohet ne menyre positive, vetenjojha themelor e arritur permes mjeteve te besueshme te menaxhmentit informativ, duhet te jete nje kusht paraprak i domosdoshem.

#### **IV Struktura Institucionale**

Universiteti i Mitrovices eshte i organizuar ne menyre te njejte sikurse universitetet tjera ne Serbi te dala nga ish sistemi Jugosllav. Universiteti eshte nje asociacion i shperbere i fakulteteve se tepermi autonome te cilat i organizojne punet e tyre sipas zgjedhjes se vet, dhe me vetem nje bashkepunim minimal ne mes tyre. Si rrjedhim struktura eshte teper e copetuar, dhe universiteti si nje institucion i drejtueshem mezi ekziston. Brenda nje strukture te tille, roli i udheheqesise se universitetit mund te jete vetem qe te mundohet te drejtoje fakultetet e ndryshme ne drejtim te njejte, por perfundimisht fusha per planifikim institucional eshte rreptesisht e kufizuar.

Si duket kjo strukture e tanishme eshte me teper vazhdimesi e shprehive te meparshme, me teper se sa nje zgjidhje pozitive apo nje obligim i imponuar nga fuqite e jashtme. Qarte, eshte me lehte te vazhdohet me praktiket e se kaluares se sa te zhvillohen dhe te adaptohen praktiket e reja per te ardhmen. Nje sjellje e tille institucionale eshte shume normale dhe e pritur ne nje ambient te tille te paqendrueshem. Qe universiteti te ruaj ndjenjen e vazhdimesise, eshte e kuptueshme qe praktiket e meparshme duhet te jene norma mbizoteruese te sjelljes institucionale ne kete kohe.

Megjithate, struktura universitare ka pasoja serioze negative ne punen ditore te universitetit. Ne mesin e atyre me te dukshmeve jane perkimi i pjeserishem i programeve ne mes fakulteteve, mungesa e bashkepunimit akademik ne mes fakulteteve, dhe pamundesia e universitetit te planifikoje dhe zhvillohet si nje universitet koherent

Asnje universitet modern, duke lene anash universitetin e Mitrovices ne situaten e tij te tanishme, nuk mund ti lejoje vehtes te vazhdoje ne kete menyre. Riorganizimi i tanishem i fakulteteve dhe funksioneve te UM ofron mundesi ideale te shkohet kah ky koncept struktural modern Evropian. Duke ditur kete realitet, udheheqesia e univerzitetit duhet pershendete per qendrimin pergjithesisht pozitiv dhe te hapur qe ka treguar per reformim institucional.

## **V Te arriturar e Universitetit te Mitrovices, dhe veshtiresite e kushteve materiale**

Ekipi i AUE ishte i impresionuar se sa kishte arritur universiteti per nje kohe aq te shkurter. Kthimi i serishem ne regjion ka qene pergjithesisht i karakterizuar me vendim marrje pragmatike. Objektiva kryesore ka qene qe te sigurohet dhe te rifilloje nje “sherbim normal” sa me shpejt qe eshte e mundur. Sa i perket kesaj, rindertimi dhe renovimi i ndertesave per nevoja universitare eshte drejtuar me efikasitet, edhepse kushtet materiale jane shume te veshtira, nxenia dhe mesimi tani mund te fillonin.

Ishte e qarte se hapesira e Kosoves Veriore mundeson nje realitet te veqante te vrazhde per cdo institucion te arsimit te larte. Ndonese nje imperativ politik dhe social ekziston per te siguruar dispozita per arsimin e larte ne gjuhen Serbe, ambienti nuk eshte terheqes. Ne te vertete, derisa shume universitete Evropiane po shkojne kah bota e industrise dhe biznesit per partneritet, investim, sherbime dhe lidhje tjera me komunitetet me te largeta, ne Mitrovice duket te kete fare pak ambient te punes se huaj ne te cilin institucionet mund te kujdesen per partneritet me interes te ndersjelle.

Ajo qe brengos ekipin e AUE si dhe personelin akademik dhe studentet ne universitet ishte mungesa e materialit elementar arsimor – dhe ne vecanti librat, teknologjia per informim dhe komunikim dhe pajisjet per laboratore. Gjate vizitave tona pergjate universitetit, ne mbledhjet me studentet qe “nderprenin” mesimin ne klase, ishim te goditur se si studentet posedonin shume pak libra apo ndonje tjeter material studimor elementar.

Ndonese ne disa fakultete studentet konfirmuan se mund te perdorin kompjuterin, qasje ne internet nuk ka. Kjo do te thote se studentet jane praktikisht te ndaluar te kene burime te pafund dhe qasje te lehte te informatave. Mos casja ne Internet per anetaret e komunitetit te Universitetit te Mitrovices gjithashtu do te thote qe nderkombetarizimi eshte i paralizuar, pasi qe as profesoret e as studentet nuk mund te komunikojne me te tjeret qe jane ne cilesi te barabarte ne vendet tjera.

U pa qe casja ne pajisjet kompjuterike per studentet ishte gjithashtu mjaft e kufizuar, pasi qe sallat e kompjutereve me teper ishin te mbyllura se sa te hapura. Meqenese burimet jane tashme te kufizuara me detyrime financiare, eshte e pavend te keqesohet ky problem permes nje menaxhmenti te tille te varfer.

Studentet na mundesuan informata te konsiderueshme rreth problemit te mungeses se librave. Menyra me e shpeshte e marrjes se librave eshte kopjimi i tyre nga profesoret- te cilet zakonisht jane edhe autore te tyre. Ato mund te blehen edhe ne fakultet, por cmimet sillen prej 10-20 euro – shpenzim shtese per pjesen me te madhe te studenteve ne rrethana te tilla te skajshme ekonomike. Problemi edhe me tutje komplikohet me mungesen e bibliotekes universitare, qe eshte nje problem i madh per te mundesuar literature thelbesore per studime si dhe per zvogelimin e mundesise per hulumtime te metutjeshme.

Ne disa raste ekipi i AUE ishte gjithashtu i informuar qe librat ne gjuhen Serbe qe i “takonin” universitetit mbeten ne Prishtine, dhe nuk jane “kthyer”. Sidoqofte, kur kjo

ceshtje u gjurmua, nje numer i studenteve pranuan se preferonin te gjenin menyren se si te pajisen me tekste te botuara se voni, me me deshire se sa te mundohen te kthejne, ne shume raste, librat e dala nga perdorimi nga Prishtina.

Studentet fuqimisht prezantuan veshtiresite gjate studimeve dhe kushtet jetesore ne Mitrovice dhe Zubin Potok. Shumica e verejtjeve ishin te lidhura me kushtet e pergjithshme jetesore, te karakterizuara me nderprerje te rrymes dhe ujit, te kombinuara me problemet me ngrohje ne ndertesat e fakulteteve dhe ne konvikte. Keto kushte shpesh prezantoheshin me dallimin e theksuar te kushteve te meparshme kualitative jetesore dhe per studime qe i kishin gezuar ne te kaluaren ne Prishtine, dhe shumica prej tyre besonin se studentet Shqiptare Kosovare jane tani duke perfituar prej tyre. Ndonese, nuk mund te mohohen kushtet e veshtira jetesore dhe per studime ne Universitetin e Mitrovides, qe te dyja, mbresat nga jeta qe ju kujtohej ne Prishtine, dhe komoditeti i imagjinuar i qytetareve te sotem te Prishtines, dukej se teper ekzagjeroheshin nga e verteta.

Kapacitetet per konvikte jane mundesuar, dhe vazhdojne te zhvillohen. Megjithate, ato nuk munden plotesisht ti adresojne veshtiresite rreth akomodimit te studenteve ne Mitrovice, dhe me te vertete ceshtja e numrit jo te mjaftueshem te dhomave ne konvikte, mbushja e dhomave perplot me studente si dhe cmimet e akomodimit privat ishin probleme shpesh te nderlidhura ne biseda.

Studentet gjithashtu theksuan se nuk kane kapacitete per biblioteka, kapacitete sportive, kapacitete kulturore, as ne Mitrovice e as ne Zubin Potok. Nuk ekziston nje vendtakim i studenteve (kafeteri apo qender e studenteve) ku studentet mund te shoqerohen. Ne pyetjen se cka bejne gjate kohes se shumte te lire, studentet u pergjegjen se ata shoqerohen ne dhomat e njeri tjetrit apo flejne.

Disa ceshtje specifike u hapen ne disa fakultete te vecanta:

- Studentet ne Zubin Potok (Fakulteti Ekonomik) dhe ne Leposaviq (Fakulteti Pedagogjik) ishin posaqerisht te brengosur me mungesen e cfaredo kapaciteti (bibliotekes, vendeve shoqerore/kulturore, kapaciteteve sportive) ne fshatrat ku fakultetet jane te vendosura, dhe ndjenja e te qenit "larg nga vendet/aktivitetet (e ardhshme) e studenteve ne Mitrovice";
- Studentet e Ekonomikut thane se nuk mund te kene qasje ne ndertesen e fakultetit jashte orarit te kohes kur mbahen oret – qe si duket eshte suate e njejte edhe ne fakultetet tjera.;
- Studentet dhe profesoret ne fakultetin e Arteve (drejtimi i piktures) u ankuan shume per hapesiren e kufizuar dhe joadekuate ne te cilen punojne;
- Studentet e Mjekesise ishin te brengosur per kushtet shume te veshtira ne ndertesen e spitalit ne te cilen punojne, dhe me faktin se nuk ka paciente ne spital, por ata nuk ishin ne gjendje te sugjerojne paisjet urgjentisht te nevojshme per permiresimin e studimeve te tyre. Nje student e permendi se 'vetem studentet me te vjeter qe kane studiuar me pare ne Prishtine dhe qe kane punuar me paciente [ne makina] kane njohuri praktike'. Ne baze te studentit te njejte 'gjeneratat e mevonshme nuk iu kane ekspozuar cfaredoqofte trajnimi praktik'

- Studentet e fakultetit të Teknologjise gjithashtu permenden si problem mungesen e paisjeve, dhe, sikurse studentet e mjekesise, ishin te paqarte se cfare paisje ne te vertete iu nevojiteshin.

## **VI Burimet financiare**

Universiteti eshte punedhenesi me i rendesishem publik ne Kosoven veriore dhe per momentin eshte teresisht i mbeshtetur nga financimi publik. Financat e Universitetit nuk u prezantuan ne menyre transparente, megjithate siq u cek ne disa raste asnje mjet financiar i rendesishem nuk ka ardhe permes buxhetit te Kosoves.

Mjetet financiare jane siguruar ne rradhe te pare nga shteti Serb, ndonese nuk eshte e qarte as sa te holla jane siguruar, e as nuk dihet menyra se si keto mjete jane drejtuar (duket se financimi behet nga me shume se nje departament qeveritar, por pasi shume pak spjegime na u ofruan, eshte e pamundur qe permes ketij raporti te jipen komente rreth kesaj ceshtje). Sikurse financat e shtetit Serb poashtu edhe financat e Universitetit te Mitrovices mbeten te padeptueshme, dhe ne rrethana te tilla mbetet e pamundur te njihen nevojat themelore demokratike te pergjegjesise publike. Nese financat ekzisuese universitare nuk prezantohen haptas, kjo gjithashtu do te krijojte pengesen kryesore ne cfaredo aktiviteti per mbledhjen e te hollave me donatore nderkombetare.

Ndonese marreveshjet e tanishme financiare universitare – para se gjithash marreveshja ne mes shtetit Serb dhe Universitetit te Mitrovices – mund te jene te kuptueshme prej kendveshtrimit te nje institucioni pragmatik, prapseprapë ato jane problematike per zhvillimin afatgjate. Ne te vertete, besimi ne nje mekanizem te tille te financimit mund te tregohet si nje politike shkurtpamese ne nje te ardhme shtjelluese, dhe per kete eshte e rendesishme per universitetin qe te drejtohet kah e ardhmja Evropiane ne te cilen do te luaj rol te zbatueshem. Ne kete kontekst, udheheqesia universitare eshte duke punuar ne planet e reformes te cilat cojne kah zhvillimi racional dhe pozitiv i universitetit.

## **VII Idetë rreth reformës**

Ndonese universiteti i ka zhvilluar planet e reformes, dhe me te vertete tashme ka filluar me implementim, pergjithesisht, ne mesin e profesoreve dhe studenteve, shume pak arsyetohej se pse reformat jane te nevojshme, dhe ne te vertete kishte nje rezistence te konsiderueshme perbrenda universitetit per disa propozime specifike. Derisa per nje vezhgues te jashtem, ceshtja e reformes eshte mbizoteruese, per udheheqesine e universitetit dhe per personelin novator eshte me rendesi te pranohet fuqia e ndjesise kunder cfaredo ndryshimi ne universitet, dhe te ndermirren hapa per ti binde akteret e ndryshem per arsyet te cilat i nenshtrohen projektit te reformes. Sidoqofte idete e mira qe jane zhvilluar per reforme, do te perfundojne keq nese nuk perkrahen nga palet kryesore te interesuara. Prandaj eshte jetike qe nje diskutim dhe debat publik, te cilen ne njefare menyre e shkaktuam me viziten tone, te vazhdoje ne vitin 2003.

Shtytja kryesore e propozimeve te reformes universitare eshte te transformoje institucionin nga nje universitet qe pasqyron universitetet e tjera te ish Jugosllavise, ne nje universitet Evropian i cili eshte i pregaditur ti plotesoje nevojat e regjionit ne shekullin njetzet e nje. Qe nje reforme e tille te jete efektive, njohja e qarte e ketyre

nevojave eshte jetike, dhe kjo do te kerkoje nje analize rrenjesore e cila pritet te ndermirret. Akteret ne universitet gjithashtu duhet te mesojne rreth proceseve te reformes brenda universiteteve tjera Evropiane dhe ne vecanti rreth kuptimit te reformes se procesit te Bolonjes. Ndersa shume profesore dhe studente kishin degjuar per Deklaraten e Bolonjes, ishte e qarte se pergjithesisht shume pak njihej permbajtja apo objektivat e reformes se Bolonjes.

Propozimet e reformes duhet te jene ne gjendje ti bejne balle reagimeve negative bile edhe armiqesore te shume studenteve dhe profesoreve. Ne te vertete, shume studente dhe profesore qysh tani duket te jene nen bindjen e rrejshme se sistemi i tyre arsimor eshte i organizuar ne menyre gati te perkryer, dhe se thjeshte vetem kushtet materiale duhet te permiresohen.

Kur te diskutohen nevojat arsimore ne regjion duhet marre parasysh ndikimet e historise se fundit, si dhe rrethanat politike, shoqerore dhe ekonomike. Faktori tjetër kryesor eshte profili i pergjithshem arsimor i popullise, i cili sigurisht se eshte ne pozite te pafavorshme me kushtet Evropiane. Edhe pse eshte veshtire te sigurohen te dhenat, ka te ngjare qe perqindja e numrit te nxenesve qe perfundojne arsimin e mesem, te kete rene dukshem nen nivelin e vendeve tjera Evropiane, dhe se arsimi i larte ne rajon duhet te luaj rol sherues per shume nxenes ne komunitet.

Universiteti i Mitrovices nuk mund ta kryej funksionin e tij shoqeror symbyllur para ketij realiteti. Nese ringjallja e regjionit eshte synim, ai duhet te ofroje sherbime nga te cilat komunitetet vendore kane dobi maksimale – pa marre parasysh nivelin e te arriturave arsimore te studenteve me rastin e regjistrimit. Propozimi per kurse prandaj duhet te rishqyrtohet ne kushtet e nevojave arsimore te popullise Universiteti tani duhet te mendoje edhe rreth sherbimeve te synuara jo vetem per studentet e moshes shkollore pas perfundimit te shkolles se mesme tradicionale, por edhe per shume qytetare qe kane nevoja per arsim dhe trajnim me vone ne jete, me perspektive momentale te kufizuar per punesim. Per momentin Universiteti i Mitrovices vepron ne nje vakum, qe me sa duket ne nje mase te madhe nuk ka fare te beje me nevojat arsimore te regjionit dhe popullise se saj. Qe te jete ne gjendje tu pergjigjet nevojave reale, reformimi i universitetit tradicional te copezuar eshte mese i nevojshem.

## **VIII Mungesa e mekanizmave per sigurimin e kualitetit te brendshem**

Sikurse ne universitetet tjera Serbe, nuk ka fare sistem per sigurimin e kualitetit brenda Universitetit te Mitrovices. Kualiteti duhet te jete nje koncept qe prek te gjitha aspektet e jetes universitare – qofte mesimi dhe nxenia, hulumtimi, zhvillimi i resurseve njerezore, menaxhmenti dhe administrata. Mekanizmat per vleresimin e kualitetit te sherbimeve universitare jane jetike, dhe duhet te zhvillohen me pjesemarrjen e plote te studenteve. Sidoqofte, per momentin ato mungojne plotesisht.

Njohja me kulturen e sigurimit te kualitetit nuk eshte ceshtje e thjeshte, dhe do te kerkoje ne mes tjerash, procesin e zbulimit dhe mesimit nga pervojat tjera ne Evrope, si dhe pershtatjen e praktikave situates se Universitetit te Mitrovices. Vemendje e posaqme duhet ti kushtohet pikepamjeve te personelit, disa prej te cileve mund te mendojne se aktivitetet e tyre jane te kontrolluara dhe liria e tyre e zvogeluar.

Sigurimi i kualitetit nuk ka te beje me “kontrollin” por me teper me njohjen dhe sendertimin e praktikës së mirë, duke mundësuar stimulues për paraqitje të mirë dhe risi – të gjitha këto aspekte të jetës universitare që kanë nevojë urgjente për zhvillim.

## **IX Plan programet dhe metodat e mesimit**

Është jashtë kompetencave të këtij raporti që të bëjë një studim për plan programet dhe metodat e mesimit të cilat shfrytëzohen në universitet. Megjithatë, si rezultat i marrëveshjeve të tanishme organizative, ca çështje të caktuara meritojnë koment.

Së pari, siq është përmendur tashmë, ekziston një numër i konsiderueshëm i personelit akademik (deri 100% në disa fakultete) të cilët punojnë në universitet me orar “gjysem të plote”, dhe të cilët janë të punësuar dhe kanë detyrime tjera brenda dhe jashtë regjionit. Me qëllim që të përshtatet personeli i tillë, ligjeratat dhe njesitë mesimore shkojnë kah ajo që të ligjerohen dhe vlerësohen në “blloqe”, gjatë një periudhe të pënderprere apo gjatë disa prej tyre. Është tejet normale për momentin që njesitë mesimore të ligjerohen dhe shqyrtohen brenda një jave deri në dhjetë ditë, dhe gjithashtu është normale për profesoret të përcaktojnë plotësisht përmbajtjet e njesive të tyre mesimore, me fare pak ose aspak konsultime me kolegët e tyre. Prandaj profesoret i përpilojnë tekstet nga lëndet e tyre shkollore, ligjerojnë në lëndet e tyre, dhe me pastaj marrin në provim në lëndet e tyre.

Duhet përmendur se në përgjithësi, studentët i kanë lavdëruar profesoret e tyre për kualitetin e ofruar të ligjeratave, dhe kjo është një vecori pozitive e universitetit që në kohera të vështira është formuar një lidhje mjaft e afërt në mes profesoreve dhe studentëve. Sidoqoftë derisa sistemi i ligjerimit i përkrahur me lartë mund të ketë disa përparesi në rrethanat e tanishme – sidomos për profesoret vizitore – gjithashtu ekziston një numër i kufizimeve për nxënësit, si dhe pengesat prezente në kuptimin e integritetit dhe zhvillimit të plan programeve.

Marrëveshjet e tilla të planprogrameve i trajtojnë studentët si konsumatorë pasiv të njohurive të sajura. Është e pamundur që studentët të përcjellin mënyrën e tyre të mesimit brenda strukturës së plan programeve të cilat janë të paracaktuara nga prania apo mungesa fizike e një profesori të caktuar. As studentët nuk kanë mundësi të mëndojnë me gjatë për informatat, tu bëjnë pyetje profesoreve jashtë lendeve, dhe as të mbështesin njohuritë e fituara. Një zhvillim dhe integritet i tillë koherent i planprogrameve është i pamundur të arrihet me profesoret që udhetojnë në dhe nga universiteti Përvojat e mesimit, të shumicës së studentëve, ka gjasa që të jenë të copezuara, të pandryshueshme, jokreative dhe jokritike, dhe bashkësia universitare duhet të gjykojë rreth rezultateve të mundshme të një sistemi të tillë.

## **X Provimet dhe vlerësimet**

Për momentin, nuk ka kanale formale përmes të cilave studentët janë në gjendje të ndikojnë në procesin e mesimit. Një reagim struktural rreth mesimdhënies nuk ekziston, edhe pse disa profesore mund të shfrytëzojnë pyetsoret e studentëve për qëllimet e tyre.

Meqe profesoret kane autonomi totale sa i perket lendeve, here pas here mund te kete ceshtje te keqperdorimit apo abuzimit te autoritetit, por akoma nuk ka nje sistem brenda universitetit qe mirret me keto ceshtje. Megjithate, kjo nuk perceptohej nga studentet si shkaktar kryesor i brengosjes. Ne rast problemi me nje mesimdhenes te caktuar, shume studente mendojne se mund te flasin drejtperdrejt me Dekanin e tyre, gje qe eshte edhe nje shembull i maredhenieve te aferta brenda fakulteteve te vecanta.

Perkunder ketyre maredhenieve te aferta ne mes studenteve dhe profesoreve, sipas mendimit tone, pozita autoritare e profesoreve duhet te evoluojë. Duket se situata e librave te kufizuar, mos casja ne internet, dhe izolimi nga bashkesia e gjere akademike ka tendence te perforcoje sjelljet autoritative ne mesin e disa profesoreve, pasi qe jane te vetdijshem qe nuk jane te pergaditur mire me njohuri, qe tu shtrohen pyetje dhe te kundershohen nga studentet.

Ekziston edhe nje numer i problemeve shtese sa i perket procesit akademik ne kete faze te zhvillimit te universitetit.

- Duket se mesimet ne disa fakultete ende nuk kane filluar (p.sh. Bujqesi);
- Kalendaret dhe oraret mesimore jane teper te parregullta per shkak te shkembimit te profesoreve;
- Problemet e lidhura me "bllok" ligjeratat, te theksuara ne seksionin e meparshem.

Sa i perket provimeve, studentet mund te spjegonin pergjithesisht rregullat sa i perket hyrjes ne provime (sa here kane te drejte te hyjne, cilat jane kushtet e provimeve etj.), por vetem ne disa fakultete (psh. Juridik, Filologjik) studentet e dinin ne te vertete *saktesisht* se cilat jane rregullat. Ne shumicen e rasteve, pergjegjja ishte se 'hyn ne provim derisa perfundimisht e kalon'. Studentet gjithashtu u ankuan reth mosperputhjes ne mes fakulteteve sa i perket pageses per paraqitjen e provimit. Rreth kesaj ceshtje studentet bene pyetje se perse pagesat jane te ndryshme, dhe se ku perdoren keto te holla. Pyetjet e tilla jane krejtesisht valide, dhe keto ceshtje duhet te behen transparente per brenda rregulloreve te universitetit

## **XI Nevojat e Universitetit**

Nje liste e hollesishme e nevojave te universitetit ne kete faze do te mund te zhvillohej vetem permes nje procesi te brendshem gjithperfishires te konsultave – gje qe duhet te ndodh. Mirepo, nga perspektiva e jashtme e vizites sone te shkurter, duket qe mungojne disa aspekte te rendesishme te Universitetit modern Evropian.

### **1) Korniza ligjore**

Eshte me rendesi per cdo universitet qe te veproje brenda kornizes normale ligjore. Per momentin nuk ekziston nje kornize e tille, dhe kjo mungese e qartesise krijon probleme te konsiderueshme te cilat shpesh jane jashte autoritetit te institucionit per tu zgjidh.

Megjithate, mungesa e autoritetit ligjor mundet nga disa ane te kthehet ne dobi te universitetit – per shembull me zhvillimin e statutit te universitetit, qe ai deshiron te jete, jashte detyrimeve te jashtme, zakonisht te imponuar nga qeveria.

Kjo periudhe gjithashtu mundeson qe te jipen shansat per zhbllokimin e kanaleve te komunikimit si brenda universitetit poashtu edhe me komunitetin vendor. Nuk ka pengesa ligjore qe do te ndalojne pjesemarrjen e studenteve dhe profesoreve ne vendim marrje ne univerzitet, asgje qe do te ndalonte formimin e komisioneve te ndryshme te reformes, apo te ndaloje ndonje ide te mire qe te implemetohet Pra mundesite per zhvillim pozitiv universitar duhet shfrytezuar.

## 2) Personeli

Disa ceshtje te personelit ne universitet jane kritike. Ceshtja me e rendesishme eshte besimi i tepruar ne shkembimin e profesoreve, meqe ky eshte nje model qe as nuk eshte i qendrueshem e as i deshirueshem. Sipas pikepamjes sone, universiteti si ceshtje prioritare te personelit e ka te terheqe personel te ri akademik te cilet jane arsimuar per nje kohe jashte regjionit, dhe te cilet do ti sjellin universitetit kontakte te gjera akademike, si dhe zotesimin e gjuheve te huaja (te cilat per momentin jane jashtezakonisht te pazhvilluara).

## 3) Hulumtimet

Ekipi per rishqyrtim i AUE-se njohu nje mori veshtiresish te ballafaquara per sa i perket zhvillimit te universitetit, si dhe arsyet se pse zhvillimi i kapaciteteve per hulumtim nuk ishte prioriteti i pare. Sidoqofte, universiteti me pamundesi te ndermarre nje hulumtim minimal nuk mund te shtroje kerkese per titullin e universitetit. Nje institucion pa biblioteke, dhe pa komunikim me bashkesine e jashtme akademike gati se nuk mund te jetoje me titullin e institucionit arsimor. Nje universitet pa kapacitet hulumtues nuk do te jete ne gjendje te perparoje, dhe nese kjo situatë nuk eshte e drejtuar, do te kanoset ekzistenca e Universitetit te Mitrovices.

## 4) Studentet

Sikurse ne cdo institucion, studentet kane kapacitet qe ta shtyejne universitetin perpara. Ne Universitetin e Mitrovices, sidoqofte, studentet kane nevoja te rendesishme dhe kerkojne perkrahje. Brenda universitetit, studentet me telashe duhet te perkrahen me teper ne programet e tyre studimore. Studentet poashtu duhet te perkrahen ne perpjekjet e tyre qe ti sjellin ndryshime positive universitetit. Shume duhet te mesohet nga kontaktet me rrjetat e jashtme te studenteve dhe nga organizatat e jashtme Nevoja me jetike prandaj eshte qe te krijohen kontakte me komunitetin studentor Evropian.

## **XII   PERFUNDIM**

Duke njohur kompleksitetin e sfidave me te cilat perballohet universiteti, si dhe pamjaftueshmerine e informative baze per kete raport, do te ishte pamaturi te ofrohej nje deklarate e qarte perfundimtare. Ne vend te kesaj, ne do te deshironim te konstatojme dhe shpresojme qe kjo vizite e pare dhe ky raport do te jene pike nisje per bashkepunim dhe zhvillim te ardhshem te Universitetit te Mitrovices, dhe hapi i pare i rendesishem kah e ardhmje Evropiane

Ne e pranojme qe komuniteti akademik Evropian ka gjithashtu pergjegjesi te reagoje ndaj nevojave te universitetit dhe te regjionit, dhe se AUE do te perpiqet ti pergjigjet universitetit ne menyre sa me te dobishme dhe perkrahese qe eshte e mundur. Pershtypjet dhe kujtimet e fuqishme nga vizita jone do te mbeten me ne, dhe presim me padurim me optimizem dhe shprese qe te punojme se bashku ne te ardhmen.